




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Drejtoria e Arsimit
Kamenicë

Nr.346
Datë:13.08.2026

Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr.04/L-032, Ligji për Arsimin dhe Afësimin Profesional Nr. 04/L-138, si dhe në Udhëzimin Administrativ të MASHT Nr. 22/2013, Njoftimi nr.03/2838, i datës 29.06.2026 i lëshuar nga MASH, Drejtoria e Arsimit shpall:

KONKURS PLOTËSUES

**PËR REGJISTRIMIN E NXËNËSVE NË KLASËN E DHJETË (10) NË
GJIMNAZ DHE IAAP PËR VITIN SHKOLLOR 2026/27**

KUSHTET DHE KRITERET E KONKURSIT

1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e nxënësve të rregullt

Për regjistrimin e nxënësve në klasën e 10-të, në gjimnaze dhe IAAP, për vitin shkollor 2026/27, mund të konkurrojnë kandidatët, të cilët e kanë mbaruar arsimin e obligueshëm dhe nuk janë më të vjetër se 17 vjeç.

Nxënësit, të cilët e kanë përfunduar klasën e 9-të jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë njohjen e dëftesave në MASHTI dhe më pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

2. Dokumentet e nevojshme për konkurrim

Nxënësit për të konkurruar për regjistrim në klasën e 10-të në gjimnaze dhe IAAP, duhet t'i paraqesin këto dokumente:

- **Fletëparaqitjen** (e cila merret në shkollën në të cilën konkurron)
- **Dëftesën origjinale** për kryerjen e shkollës së mesme të ulët (6-9) dhe
- **Ekstraktin** e lindjes.

3. Afati i paraqitjes së dokumenteve dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve për gjimnaze dhe IAAP për vitin shkollor 2026/27, bëhet **përmes dorëzimit fizik të dokumenteve** më datat 17, 18 dhe 19 **gusht 2026**, në lokalet e shkollës amë, ku nxënësi dëshiron të regjistrohet duke filluar nga ora **08:00 - 16:00**.

Rezultatet për pranimin e nxënësve shpallen në shkollat përkatëse më datën **20.08.2026**

Nxënësi i pakënaqur me rezultatin e publikuar, ka të drejtë ankese brenda dy (2) ditë pune, nga koha e shpalljes së rezultateve.

Ankesa parashtrohet në drejtorinë e shkollës. Ankesat në shkallën e dytë bëhen në Drejtorinë Komunale të Arsimit brenda dy (2) ditë pune, pas pranimit të përgjigjes nga shkolla.

A. Kriteret për regjistrim

Nxënësi për regjistrim në klasën e 10-të duhet t'i plotësojë këto kriteret:

- | | |
|---|---------------|
| 1. Suksesi nga shkollimi i obliguar | (40%) 40 pikë |
| 2. Suksesi nga lëndët prioritare nga shkollimi i obliguar | (20%) 20 pikë |
| 3. Numri i pikëve nga testi | (40%) 40 pikë |

Nxënësi maksimalisht mund t'i fitojë (100%), 100 pikë.

Kriteri i lëndëve prioritare nga suksesi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është që mesatarja e këtyre lëndëve të jetë minimum 4.00 (Së pari

llogaritet mesatarja e lëndëve veç e veç për klasat (6-9), pastaj mesatarja e mesatareve të atyre lëndëve).

Kriteri i lëndëve prioritare nga testi për gjimnaze dhe shkolla të mesme të mjekësisë është minimumi 40% i pikëve nga ato lëndë.

1. Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i shkollimit të obligueshëm (kl. 6, 7, 8, 9) mund t'i fitojë maksimalisht 40 pikë.

Formula për llogaritjen e pikëve të suksesit është:

$$\text{Suksesi (kl. 6+ kl. 7+ kl. 8+ kl. 9)} \times 2 = 40 \text{ pikë max}$$

Nxënësi nga suksesi i përgjithshëm i lëndëve prioritare, maksimalisht mund t'i fitojë 20 pikë.

$$\text{mesatarja e lëndës (I)} + \text{mesatarja e lëndës (II)} + \text{mesatarja e lëndës (III)} + \text{mesatarja e lëndës (IV)} = 20 \text{ pikë max}$$

- **Lëndët me prioritet në sukses sipas drejtimeve të gjimnazeve:**

- a. Gjimnazi i shkencave natyrore:

Fizikë, Kimi, Biologji, Matematikë

- b. Gjimnazi i shkencave shoqërore dhe gjuhësore:

Gjuhë amtare, Gjuhë angleze, Histori, Gjeografi

- **Lëndët me prioritet në sukses sipas profileve në IAAP**

- a. Makineri, Elektroteknikë, TIK, Tekstil, Gjeodezi, Ndërtimtari, Xehetari, Gjeologji, Grafikë, Komunikacion, Kimi — Teknologji, PTT:

Matematikë, TIK, Fizikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi

- b. Ekonomi, administratë:

Matematikë, Gjuhë shqipe dhe letërsi, Gjuhë angleze, Gjeografi

- c. Tregti, Hotelieri dhe Turizëm:

Gjuhë shqipe dhe letërsi, Histori, Edukatë qytetare, Gjeografi

PLANIFIKIMI PËR REXHISTRIM NË KLASAT E X-ta NË v.sh.

2026/27 NË GJIMNAZE DHE IAAP

Gjimnazi "Ismail Qemali"

Shkolla	Drejtimi	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
Gjimnazi "Ismail Qemali" Kamenicë	Shkenca të natyrës	1	32
	Shoqëror dhe gjuhësor	1	28
Numri:		2	60

ShMLM "Sejdi Kryeziu"

Shkolla	Drejtimi	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
ShMLM "Sejdi Kryeziu" Roganë	Shkenca të natyrës	1	26
	Shoqëror dhe gjuhësor	1	25
Numri:		2	51

Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr. i paral.	Nr. i Nxën.
"Sejdi Kryeziu" Roganë	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Teknik i informatikës së biznesit	1	2
	Hotelieri	Kuzhinier-Dual	1	14
Gjithsej: S. Kryeziu			2	16

IAAP "Andrea Durrsaku"

Shkolla	Drejtimi	Profili	Nr.i paral.	Nr.i nxën.
"Andrea Dursaku" Kamenicë	Makineri, prodhim dhe ndërtimtari	Instalues i ngrohjes, klimatizimit dhe ujësjellësit -Dual	1	6
		Metaltpunues-Dual	1	6
	Teknologji e informacionit dhe komunikimit	Zhvillues i aplikacioneve softuerike	0	0
	Hotelieri	Kuzhinier-Dual	1	8
Gjithsej: A. Durrsaku			3	20



Drejtori i Arsimit

Selami Klaiqi